

VENDIM
Nr. 130, datë 22.2.2012

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË
SEGMENTIT RRUGOR MAMINAS-GJIRI I LALZIT**

(Ndryshuar me VKM nr. 559, datë 22.8.2012)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor Maminas-Gjiri i Lalzit.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 93 989.8 (nëntëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë pikë tetë) m², tokë truall dhe arë, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 43 865 699 (dyzet e tre milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë.
4. Shpenzimet procedurale, në shumën 4 977 000 (katër milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
5. *Shuma e palikuידuar prej 43 733 209 (dyzet e tre milionë e shtatëqind e tridhjetë e tremijë e dyqind e nëntë) lekësh nga vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 43 865 699 (dyzet e tre milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesëmijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekësh, do të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.*
6. Shpronësimi të fillojë më 1.3.2012.
7. Për pasuritë, për të cilat në kolonën përkatëse është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, pronarët do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve do të kryejë likuidimin e pronarëve të pasurive, për të cilat është bërë shënimi përkatës “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë.
9. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.
10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha